



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 539/3 Prot.

Tiranë, më 28/6 /2016

REKOMANDIM

Nr. 15, datë 28/6 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit 44/2015, datë 30.05.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "*Posta Juaj*" (*Artan Tujani - person fizik me Nipt L31303022B*), Tiranë

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 120, datë 09/05/2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "*Posta Juaj*" (*Artan Tujani - person fizik me Nipt L31303022B*), me objekt:

- *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Kontrolluesi "*Posta Juaj*" (*Artan Tujani*) ushtron aktivitet tregtar në fushën e Email-Marketing, prej tetë vitesh. Email - Marketing është një marketing i drejtpërdrejtë i realizuar përmes dërgimit të një mesazhi komercial (reklamë ose mesazh promocional), në adresat Email të shumë përdoruesve, të konsideruar si konsumator potencial (subjekte të të dhënave). Fushatat e marketingut kryhen për llogari të kompanive të ndryshme private që operojnë në Shqipëri. Këto fushata janë të reklamuara edhe në faqen online postajuaj.com, të këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi ka krijuar një bazë të dhënash personale ose sistem arkivimi (më shumë se 100 mijë adresa email) të cilat i përdor gjatë fushatave të email-marketingut. Gjatë veprimtarisë së tij kontrolluesi përpunon kategorinë e të dhënave personale "adresë e-maili" për kategoritë e subjekteve "Klientë".

1. Kontrolluesi realizon marketing të drejtpërdrejtë (email-marketing) ndaj subjekteve të të dhënave. Teknikisht kjo veprimtari realizohet duke përdorur ndërfaqe me pagesë që ofrohen nga faqet online "*Email-Marketer*" dhe "*Mad Mimi*", të cilat aksesohen në adresat e tyre përkatëse përmes internetit (<http://interspire.com/emailmarketer/>) (<https://madmimi.com/>). Adresat e-mail që kontrolluesi disponon në kompjuterin e tij, ngarkohen në faqet online të mësipërme të cilat ofrojnë opsionet për të menaxhuar këtë proces deri në dërgimin përfundimtar të email-eve komercial tek subjektet e të dhënave.



Përmbajtja e email-eve përcaktohet nga kompanitë që paguajnë kontrolluesin për të realizuar këtë shërbim.

Kontrolluesi pretendon se ka siguruar adresat e-mail nga subjektet e regjistruar në rubrikën newsletter në faqen [infinite.al](http://infinite.al), e cila administrohet nga i njëjti kontrollues. Regjistrimi vullnetar i adresës e-mail në këtë faqe nënkupton dhe marrjen e pëlqimit. Numri i madh i adresave e-mail që kontrolluesi disponon dhe fakti që operon prej 8 vitesh në treg ndërkohë që [infinite.com](http://infinite.com) është domain i ri, e bën pak të vlefshëm këtë pretendim.

Konstatohet që në emaillet që kontrolluesi dërgon ka të vendosur një *link* për çregjistrimin e adresës e-mail të subjektit të të dhënave nga databaza (baza e të dhënave) e kontrolluesit, në rast se ky i fundit nuk dëshiron të marr më e-mail të tilla.

Kontrolluesi nuk është në gjendje që të provojë marrjen e pëlqimit të subjekteve të të dhënave për dërgimin e email-eve të marketingut, sipas nenit 3 pika 24 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 1/a të këtij ligji. Respektimi i nenit 6/1/a bën të mundur që kontrolluesi të regjistrojë subjektet e të dhënave personale drejt të cilëve dërgohen komunikimet tregtare të pakërkuara në varësi të pëlqimit paraprak që ata kanë dhënë, kjo edhe në zbatim të nenit 9/3 të ligjit nr.10128, datë 11.05.2009 *“Për tregtinë elektronike”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ekzistenca e pëlqimit të klientëve është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit, referuar nenit 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të Ligjit, *“duhet të jetë në formën e një deklarate me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij”*. Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe *“Parimin e ligjshmërisë së përpunimit”*, sanksionuar në nenin 5/1/a të Ligjit.

Në një shoqëri moderne të konsumit shërbimet e marketingut direkt janë në rritje të vazhdueshme, prandaj është e rëndësishme që kontrolluesit e të dhënave personale t'i përdorin ato vetëm në përputhje me të drejtat themelore të njeriut. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian parashikon se: *“Gjithëkush ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me veten e tij apo të saj. Të dhëna të tilla duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të drejtë për qëllimet e specifikuar dhe në bazë të pëlqimit të personit të interesuar, ose në bazë legjitime të përcaktuara me ligj. Gjithkush ka të drejtën e aksesit ndaj të dhënave të cilat janë mbledhur në lidhje me të dhe të drejtën për të korrigjuar të dhënat”*.

2. Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ konstatoi se kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar. Në faqen e kontrolluesit [www.postajuaj.com](http://www.postajuaj.com) nuk janë të parashikuara në një rubrikë të veçantë *“politikat e privatësisë”*.

Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet,



ka detyrimin që të publikojë "Politikat e privatësisë", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i "Politikave të privatësisë" përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i ligjit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se nuk është përmbushur detyrimi për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;

*Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".*

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

4. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk kishte hartuar një "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverballi i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ (që mban datën 30.05.2016).

Në përmbajtje të procesverbalit, përfaqësuesi i kontrolluesit, deklaroi: "*Nuk jam subjekt i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Prapësimet dhe provat do të paraqesë në seancën dëgjimore*". Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit i ka përcjellë pretendimet në rrugë elektronike (me e-mail) në adresë të Zyrës së Komisionerit. Pretendimet u administruan në cilësinë e provës dhe lidheshin kryesisht me mënyrën e mbledhjes së të dhënave (adresat e e-maileve), pëlqimin e subjekteve të të dhënave, mundësinë e çregjistrimit etj.

Në vijim, në datën 13.06.2016 (ora 10:50) u zhvillua seanca dëgjimore në të cilën përfaqësuesi i kontrolluesit Z. Tujani paraqiti edhe në formë shkresore të gjitha pretendimet



dhe bashkëlidhur dorëzoi në cilësinë e provës "Sqarime në lidhje me aktin e hetimit administrativ të datës 30 maj 2016".

Në tërësi përfaqësuesi i kontrolluesit pretendon se subjekti (*Artan Tujani - person fizik me Nipt L31303022B*) nuk është kontrollues pasi e-maili nuk është e dhënë personale por e dhënë anonime. Pretendon se nuk disponon një sistem arkivimi dhe nuk është subjekt i ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar por i ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (neni 128).

Referuar pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura si provë, Zyra e Komisionerit vlerëson:

- E-maili konsiderohet si "e dhënë personale" sipas nenit 3/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, pasi e bën të identifikueshëm subjektin e të dhënave. Në varësi të ndërtimit të tij, identifikimi mund të bëhet drejtpërdrejtë (kur e-maili përmban emër dhe mbiemër) ose indirekt duke u shoqëruar me të dhëna të tjera personale. Edhe pse subjekti (*Artan Tujani - person fizik me Nipt L31303022B*) përpunon vetëm këtë kategori të dhënash personale (pra e-mailin) kjo nuk e shmang atë nga fakti i të qenit "kontrollues" në bazë të ligjit nr. 9887. Në këtë kuadër konsiderohet subjekti i ligjit nr. 9887 dhe duhet të zbatohet të gjitha detyrimet që parashikon. Emaili nuk mund të konsiderohet e dhënë anonime pasi në këtë koncept përfshihen ato të dhëna që në asnjë rast dhe gjithmonë nuk e identifikojnë dot subjektin e të dhënave (psh. në praktikë njihet inicialet e një emri).

Edhe nga praktika europiane adresat e e-mailit konsiderohen të dhëna personale. Në vijim disa shembuj:

- Agjencia Europiane për të Drejtat e Njeriut shprehet se ndër të tjera edhe e-maili është e dhënë personale (<http://fra.europa.eu/en/data-protection>);
- Autoriteti Anglez për Mbrojtjen e të dhënave ([https://ico.org.uk/media/for-organisations/documents/1591/personal\\_information\\_online\\_cop.pdf](https://ico.org.uk/media/for-organisations/documents/1591/personal_information_online_cop.pdf));
- Pretendimi se nuk administrojnë një sistem arkivimi nuk qëndron pasi mënyra e administrimit dhe përpunimit të të dhënave nga ana e kontrolluesit kryhet në mënyrë elektronike nëpërmjet një sistemi kompjuterik dhe sistemi arkivimi elektronik, në përputhje me nenet 4/1 dhe 3/8 të ligjit nr.9887.
- Veprimtaria e kryer nga kontrolluesi në këtë rast konsiderohet tregtim i drejtpërdrejtë në bazë të përkuftizimit në nenin 3/11 të ligjit nr. 9887. Reklamimi që kryen kontrolluesi kryhet nëpërmjet e-mailit. Si kusht kryesor për kryerjen e kësaj veprimtarie është pëlqimi i subjekteve të të dhënave personale (mbajtësit e këtyre adresave të e-mailit, qytetarët) referuar nenit 6/1/a dhe 6/5 të ligjit nr.9887. Në këtë rast veprimtaria e kontrolluesit duhet të jetë konform ligjit nr. 9887 dhe Udhëzimit nr. 16 datë 26.12.2011 për "Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë", që rregullon në mënyrë specifike këtë veprimtari.

- Pavarësisht ekzistencës së mundësisë së çregjistrimit nga marrja e e-mailit të marketingut, dërgimi i e-mailit pa pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave do të konsiderohet shkelje në bazë të ligjit nr.9887.

Në kushte të tilla Zyra e Komisionerit vlerëson se në cilësinë e kontrolluesit, subjektit *“Posta Juaj” (Artan Tujani - person fizik me Nipt L31303022B)* i lind detyrimi për të plotësuar të gjitha detyrimet ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, të sanksionuara në Ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30, 31 pika 1/ “a/1” dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar,

### **REKOMANDOJ:**

1. Në zbatim të nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, të sigurohet dhe të provohet marrja e pëlqimit paraprak për të gjithë subjektet e të dhënave, e-maillet e të cilëve përpunohen dhe administrohen nga ana juaj në cilësinë e kontrolluesit me qëllim realizimin e marketingut. E-maillet për të cilët nuk është dhënë pëlqim duhet të fshihen nga sistemi elektronik. Të kontrollohet rregullisht dhe të respektohet regjistri i përjashtimeve për subjektet e të dhënave personale të cilëve ju jeni drejtuar por që nuk kanë dëshirë të marrin komunikime të tilla marketingu;
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, në çdo email që synohet të dërgohet të parashikohet edhe informimi i subjekteve të të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë. Gjithashtu në faqen e kontrolluesit [www.postajuaj.com](http://www.postajuaj.com) të publikohet në një rubrikë e veçantë mbi *“politikat e privatësisë”*;
3. Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, të përmbushet detyrimi për njoftim;
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga aktet përkatëse.
5. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.



6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 28/6 /2016

